REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-060/2698
Nr. i faq. 1
Data 21/04/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

**Republika e Kosovës**
**Kuvendi i Komunës së Junikut**
**Numër: 002/11**
**Datë: 21.04.2026**

Në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 30 paragrafi 6 të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26 i datës 29.9.2010) dhe nenit 8 të Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Junikut iu bënë këtë:

# FTESË

**Për:** Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut
**Nga:** **Leonard Llolluni** – kryesues i Kuvendit të Komunës së Junikut
**Lënda:** Mbledhja e katërt - (2026) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Junikut
**Vendi:** **Salla e Kuvendit të Komunës së Junikut**
**Data:** **30.04.2026**, ora **10 $^{00}$**.

## Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Rishqyrtimi i vendimit me nr.2-180/1632, për komisionin për themelimin e Këshillave lokale,
3. Rishqyrtimi i vendimit me nr.2-180/2273, për listën e pronave që planifikohen të jepen në shfrytëzim nga Komuna e Junikut,
4. Rishqyrtimi i vendimit me nr,2-180/1638, për themelimin e Komitetit për Arsim,Shkencë,Kulturë,Rini dhe Sport,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Kuvendit për vitin 2026,
6. Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën Janar – Mars 2026,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurës për plotësim ndryshim të rregullorës për taksa komunale për vitin 2027,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimeve të Rregullorës për menaxhimin e mbeturinave (Leximi i dytë),
9. Të ndryshme,

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 03-180-2356
Nr. i faq. 1
Data 08/04/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 08.04.2026 |
| PËR/ZA/TO: | **z.Leonard Llolluni** - Kryesues i Kuvendit Komunal |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | **z.Ruzhdi Shehu** - Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | **znj.Leonora Shehu** – U.D Drejtoreshë për Administratë të Përgjithshme |
| TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT: | Kërkesë |

I nderuar,

MAPL pas shqyrtimit të përmbajtjes së vendimit për themelimin e Këshillave Lokale, i miratuar nga Kuvendi Komunal më 27.02.2026, vendimi me nr. 2-180/1632, vlerëson se është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi, konkretisht me ligjin Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore dhe Udhëzimin Nr.02/2019. Komisioni duhet të jetë në pajtim me nenin 6, paragrafët 7 dhe 8 të ligjit Nr. 05/L -020 për Barazi Gjinore, dhe nenin 5, paragrafin 3 të Udhëzimit Nr.02/2019.

Kërkojm që në seancën e radhës të Kuvendit Komunal të rishqyrtohet vendimi i lartëcekur dhe të harmonizohet me legjislacionin në fuqi.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot. 2-155/2518
Nr. i faq.
Data 15/04/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 15.04.2026 |
| PËR/ZA/TO: | z. Leonard Llollumi – Kryesues i Kuvendit Komunal |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z. Ruzhdi Shehu - Kryetar i Komunës, Junik |
| NGA/OD/FROM: | znj. Ardita Hoxha - Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për të shtuar në rend dite në KPF dhe në Kuvend Komunal inicimin e procedurave të Rregullores për taksa komunale për vitin 2027. |

I nderuar,

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje lokale 03/L-040, neni 12, pika c, Ligjit për Financat e Pushtetit lokal: Nr. 03/L-049, neni 8 i Rregullores së punës së Kuvendit, ), Ligji Nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin, kërkojmë që të nxirret vendimi për lejimin e fillimit të procedurave për plotësim ndryshimin e Rregullores për Taksa Komunale për vitin 2027.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa kërkon nga ana juaj që të kemi në rend dite inicimin e procedurave të Rregullores për Taksa Komunale për vitin 2027.

Me respekt!

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
Ozn/Nr. Prot. 2-155/2432
Nr. i faqe 1
Data 10.04.2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| DATË/A: | 10.04.2026 |
| PËR/ZA/TO: | z. Leonard Lloluni - Kryesues i Kuvendit Komunal |
| PËRMES/PREKO/THROUGH: | z. Ruzhdi Shehu -Kryetar i Komunës |
| NGA/OD/FROM: | znj.Ardita Hoxha- Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Kërkesë për të shtuar në rend dite në mbledhjen e KPF-së dhe Kuvendit Komunal raportin financiar Janar-Mars për vitin 2026 |

I nderuar,

Në bazë të ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr: 03L/048 neni 45, paragrafi 45.4 ku është detyrë e Egzekutivit që në periudha tremujore dhe vjetore të raportoj para Kuvendit Komunal, atëherë kërkojmë që të shtohet në rend dite në mbledhjen e ardhshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, raporti financiar mbi Buxhetin dhe Shpenzimet për periudhën Janar- Mars 2026.

Të bashkangjitur në kërkesë keni raportin e përgatitur nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Me respekt,

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK-OPSTINA JUNIK-MUNICIPALITY JUNIK

Numër : 002/1
Data : 21.04.2026

# DRAFT - PLANI I PUNËS SË KUVENDIT KOMUNAL NË JUNIK PËR VITIN 2026

## Hyrje:

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale (neni 35 paragrafi 35.1 i LVL-së).

Kuvendi i Komunës së Junikut ka për obligim të zbatojë rolin e tij legjislativ dhe drejtues në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe ligjet e tjera të Republikës së Kosovës.

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026 është dokument orientues i aktiviteteve të Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026, duke paraqitur veprime konkrete të planifikuara, me qëllim të përmbushjes së detyrave të tij në fushën e legjislacionit dhe të mbikëqyrjes si dhe të ngritë transparencën dhe llogaridhënien para qytetarëve Junikas.

Ky plan mund të pësoj ndryshime varësisht prej nevojave që paraqiten me kalimin e kohës.

**Objektivat**

a) Si organi më i lartë, Kuvendi i Komunës së Junikut ka për objektiv krijimin e kornizës ligjore që definon parametrat brenda së cilës:

1.do të funksionojë administrata (ekzekutivi),

2.do të mbikëqyrë dhe monitorojë aktivitetet e administratës (ekzekutivit) për t'u siguruar se ato janë në përputhje me kornizën ligjore,

3.në bashkëpunim me administratën (ekzekutivin), të vendosë drejtimin strategjik për zhvilllmin ekonomik, fizik dhe financiar të Komunës së Junikut, dhe

4.siguron që parimet e një shoqërie demokratike janë të qëndrueshme në mënyrën me të cilën realizon rolin e tij legjislativ dhe drejtues.

**Qëllimi**

b) Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut shërben si mjet për ti arritur qëllimet e mëposhtme përmes planifikimit të plotë dhe të kujdesshëm.

Plani i punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2026:

1.siguron që Kuvendi i Komunës së Junikut po i përmbush obligimet ligjore duke i miratuar të gjitha rregulloret që i parasheh ligji dhe që janë të nevojshme për shfrytëzim efektiv të resurseve të Komunës së Junikut,

2.shërben si një instrument me anë të të cilit Kuvendi i Komunës së Junikut mund të mbikëqyrë punën e administratës (ekzekutivit) përmes dorëzimit të raporteve financiare dhe të perfomancës,

3.funksionon si mjet që shton gjasat për arritjen e objektivave të Komunës së Junikut përmes ndërtimit të një kornize ligjore të qëndrueshme,

4.ngrit efikasitetin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut dhe të administratës (ekzekutivit) në përgjithësi, dhe

5.ngrit transparencën e Kuvendit të Komunës së Junikut. (Qytetarët janë të informuar për aktivitetet e planifikuara paraprakisht dhe kësisoj mund të jenë më të frytshëm në punën e Kuvendit të Komunës së Junikut, në veçanti duke dhënë kontribut në vendimet që kanë rrjedhoja afatgjata dhe të rëndësishme financiare, ekonomike dhe sociale në Komunën e Junikut.)

| *Muaj* | *Aktivitetet e Kuvendit* | *Data* | *Aktivitetet e Komitetit për Politikë dhe Financa* | *Data* | *Aktivitetet e Komitetit për Komunitete* | *Data* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 1.Shqyrtimi I Raportit financiar për tremujorin e katert, tetor-dhjetor 2026;<br><br>2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit për Komunitete për vitin 2026, | 02.02.2026 | 1.Shqyrtimi I Raportit financiar për tremujorin e katert, tetor-dhjetor 2026;<br><br>2.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit për Komunitete për vitin 2026, | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2026,<br><br>4.Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026;<br><br>5.Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2025;<br><br>6.Raporti i punës së KKSB-së për vitin 2025;<br><br>7.Shqyrtimi i Raportit të punës së prokurimit për vitin 2025; | | 3.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës i komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2026,<br><br>4.Shqyrtimi I Raportit të punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026;<br><br>5.Shqyrtimi i Raportit të punës së Kryetarit për vitin 2025;<br><br>6.Raporti i punps së KKSB-së për vitin 2025;<br><br>7.Shqyrtimi i Raportit të punës së prokurimit për vitin 2025; | | | |
| Shkurt | Seancë solemne me rastin e ditës së pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt);<br><br>1.Raporti i buxhetit për vitin 2025;<br><br>2.Informatë rreth mirembajtjes / pastrimit nga | 27.02.2026 | Seancë solemne me rastin e ditës së pavarësisë së Republikës së Kosovës (17 shkurt);<br><br>1.Raporti i buxhetit për vitin 2025;<br><br>2.Informatë rreth mirembajtjes / pastrimit nga bora / te rrugeve lokale në zezonin e dimrit; | 18.02.2026 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | bora / te rrugeve lokale në zezonin e dimrit; | | | | | |
| Mars | 1.Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiscal 2025;<br><br>2.Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026,<br><br>1.Njoftim mbi shfrytezimin e pronave Komunale; | 31.03.2026 | 1.Shqyrtimi dhe miratimi i raportit financiar për vitin fiscal 2025;<br><br>2.Shqyrtimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026,<br><br>3.Njoftim mbi shfrytezimin e pronave Komunale; | 20.03.2026 | | |
| Prill | 1.Shqyrtimi i raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e pare janar-mars 2026;<br><br>2.Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut;<br><br>3.Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut;<br><br>4.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt | 30.04.2026 | 1.Shqyrtimi I raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e pare janar-mars 2026;<br><br>2.Informatë lidhur me gjendjen e shërbimeve publike në komunën e Junikut;<br><br>3.Informatë lidhur me gjendjen e arsimit në komunën e Junikut;<br><br>4.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2026; | 21.04.2026 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2026;<br><br>5.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa per vitin 2026; | | 5.Nxjerrja e vendimit për fillimin e plotësim-ndryshimeve të projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa per vitin 2026; | | | |
| Maj | 1. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në komunën e Junikut;<br><br>2. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2026/28 të Ministrisë së Financave; | 29.05.2026 | 1. Informatë mbi zhvillimin e sektorit të turizmit në komunën e Junikut;<br>2. Informatë lidhur me Qarkoren Buxhetore 2026/28 të Ministrisë së Financave; | 20.05.2026 | | |
| Qershor | Seancë solemne me rastin e Ditës së Çlirimit të komunës së Junikut (13 qershor);<br><br>1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028; | 13.06.2026<br>30.06.2026 | 1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2026-2028;<br><br>2. Rishikimi i buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2026; | 22.06.2026 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Rishikimi i buxhetit të Komunës së Junikut për vitin 2026; | | | | | |
| Korrik | 1. Shqyrtimi i raportit financiar per periudhen e dytë janar-qershor 2026;<br><br>2. Njoftim me raportin e punës së Kryetarit te komunës për 6 mujor te vitit 2026;<br>4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Vendimit për taksat komunale të ndërtimit për vitin 2026;<br>5. Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për vitin 2025;<br>6. Shqyrtimi i Raportit dhe analiza e viti shkollor2025/2026;<br>7. Njoftim mbi raportin e performances për vitin 2024; | 31.07.2026 | 1. Shqyrtimi i raportit financiar per periudhen e dytë janar-qershor 2026;<br><br>2. Njoftim me raportin e punës së Kryetarit te komunës për 6 mujor te vitit 2026;<br>4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim Vendimit për taksat komunale të ndërtimit për vitin 2026;<br>5. Informatë mbi raportin e performancës së administratës së komunës së Junikut për vitin 2025;<br>6. Shqyrtimi I Raportit dhe analiza e viti shkollor2025/2026;<br><br>7. Njoftim mbi raportin e performances për vitin 2025; | 22.07.2026 | | |
| Gusht | 1. Informatë rreth pergaditjeve per fillimin e vitit te ri shkollor 2026/2027; | 31.08.2026 | 1. Informatë rreth pergaditjeve per fillimin e vitit te ri shkollor 2026/2027; | 31.08.2026 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2. Informatë rreth korrje – shirjeve te grurit ne komunen e Junikut. | | 2. Informatë rreth korrje – shirjeve te grurit ne komunen e Junikut. | | | |
| Shtator | Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2025-2028<br><br>1. Shqyrtimim dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2026-2029;<br><br>2. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2025 nga Zyra e Auditorit Kombëtar;<br><br>3. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2027;<br><br>4. Shpallja në diskutim public e Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2027; | 28.09.2026 | Dëgjimi publik i Draft Buxhetit Komunal për vitin 2025-2028<br><br>1. Shqyrtimim dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2026-2029;<br><br>2. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Junikut për vitin 2025 nga Zyra e Auditorit Kombëtar;<br><br>3. Formimi i Grupit të punës për hartimin e projekt Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Junikut për vitin 2027;<br><br>4. Shpallja në diskutim public e Projekt Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2027; | 18.09.2026 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 5. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2026; | | 5. Shpallja në diskutim publik e Projekt Rregullores për taksa, tarifa dhe ngarkesa për vitin 2026; | | | | |
| Tetor | 1. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën e tretë janar-shtator 2026;<br>2. Informatë mbi gjendjen e shëndetit publik në komunën e Junikut;<br>3. Shqyrtimi dhe miratimi I Planit të veprimit për Efiçiencë dhe Klimë për K. Junikut; | 30.10.2026 | 1. Shqyrtimi i Raportit financiar të Komunës së Junikut për periudhën korrik-shtator 2026;<br>2. Informatë mbi gjendjen e shëndetit publik në komunën e Junikut;<br>3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të veprimit për Efiçiencë dhe Klimë për K. Junikut; | 21.10.2026 | | | |
| Nëntor | 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027;<br>2. Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve komunale dhe dokumenteve strategjike komunale. | 30.11.2026 | 1. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2027;<br>2. Informatë lidhur me zbatimin e rregulloreve komunale dhe dokumenteve strategjike komunale. | 20.11.2026 | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dhjetor | 1. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt Planit të punës së Kuvendit për vitin 2027;<br><br>2. Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyrës së Prokurimit;<br>3. Shqyrtimi dhe miratimi i Project Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale; | 30.12.2026 | 1. Shqyrtimi dhe miratimi I projekt Planit të punës së Kuvendit për vitin 2027;<br><br>2.Njoftimi me Planin vjetor të punës së Zyres së Prokurimit ;<br><br>3. Shqyrtimi dhe miratimi i Project Rregullores për Taksa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunalepër vitin 2026;<br><br>4. Shqyrtimi dhe miratimi I Projekt Rregullores per tatimin ne pronen e paluajtshme për vitin 2026; | 22.12.2026 | | |

**Sqarim:**

Grupi punues për hartimin e Planit vjetor për punën e Kuvendit Komunal me kujdes dhe përgjegjësi ka shqyrtuar te gjitha ligjet dhe aktet tjera nënligjore të nivelit qendror e të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore të Kuvendit Komunal dhe kryetarit të Komunës dhe me perpikëri dhe perkushtim më të madh i ka perfshirë në këtë plan si aktivitete me qellim që Kuvendi të jetë sa më funksional dhe përgjegjës në realizimin e kërkesave të qytetarëve, anëtarëve të Kuvendit, KPF-së, KK, dhe të kërkesave dhe përgjegjësive të kryetarit të Komunës. Mirëpo, sigurisht që dinamika e këtij plani gjatë zbatimit mund të pësoj ndryshime dhe plotësime sipas nevojës dhe paraqitjes së kërkesave të arsyeshme qoftë nga ana e qytetarëve, delegatëve të Kuvendit dhe kryetarit të Komunës apo edhe përgjegjësive të tjera që dalin nga miratimi i ligjeve të reja dhe aktiviteteve tjera nënligjore.

**Anëtarët e Komisionit për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2026:**

1. Leonard Llolluni, Kryesues- Kryesues i Kuvendit Komunal;
2. Aldi Gacaferi, anëtar i Kuvendit nga AAK;
3. Floris Miroci, anëtar i Kuvendit nga LDK;
4. Elsa Hima, anëtare e Kuvendit nga LVV;
5. Leonora Shehu, anëtare- Drejtoreshë e Administratës

- Afatet për përmbushjen dhe realizimin e aktiviteteve të parapara:

Realizimi i aktiviteteve të parapara me planin e punës së Kuvendit të Komunës së Junikut do të bëhet brenda dymbëdhjetë muajve të vitit 2026.

Kuvendi i Komunës së Junikut

z.Leonard Llolluni

Kryesues

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK
OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

| | |
|---|---|
| REFERENC-Ë: | Numër 02-03/26 |
| PËR/ZA/TO: | Anëtarët e Kuvendit Komunal Junik |
| NGA/OD/FROM | Leonard Llolluni - Kryesues i Kuvendit Komunal Junik |
| DATË/A | 31.03.2026 |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT | Procesverbal |

Në bazë të nenit 49 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 32 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Junikut, dhe nenit 18 paragrafi 1 i Rregullores së punës së Kuvendit të Komunës së Junikut, KK - Junik mbanë këtë:

**PROCESVERBAL**

Me rastin e mbajtjes së mbledhjes së tretë (3), të Kuvendit të Komunës së Junikut, me datë: 31.03.2026, duke filluar në ora 10:00. Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Junikut: z. Leonard Llolluni: i cili në fillim përshëndeti të gjithë të pranishmit ne sallë, më pas e konstatoi se prezent ne sallën e kuvendit janë 13 antaret e Kuvendit e Konunës së Junikut.

Anëtarët prezent

1. Leonard Llolluni-Kryesues,AAK
2. Bedrush Hoxha-anëtar,LDK (**Mungon**)
3. Litafete Isufa-anëtare, LDK
4. Shpejtim Gacaferi- anëtar, LDK
5. Sadri Krasniqi- anëtar, LDK
6. Floris Miroci-anëtar, LDK
7. Blerta Syla-anëtare, LDK
8. Burim Kuçi-anëtar, AAK
9. Ajshe Gacaferi-anëtare, AAK
10. Aldi Gacaferi-anëtar, AAK
11. Arlinda Pepshi-anëtare, AAK (**Mungon**)
12. Alfred Gaxherri-anëtar, AAK
13. Jetmir Tofaj-anëtar, LVV
14. Elsa Hima-anëtare, LVV
15. Lulzim Gacaferi-anëtar, LVV

**Rendi i ditës i paraparë**

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimeve në rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Kuvendit të Junikut për vitin 2025,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e planit tre (3) vjeçar për strehim social,
6. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),
7. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e "Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale" 2026-2030,
8. Pyetje nga anetarete kuvendit, dhe
9. Të ndryshme.

Rendi i ditës miratohet me 13 vota per, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota.

1. Shqyrtimi dhe Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Procesverbali miratohet me 13 vota per, 0 vota kundër dhe 0 vota abstenim.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2025 në vitin 2026,

Sqarimin dhe arsyetimin e kerkese per bartjen e te hyrave vetanake e beri znj.Ardita Hoxha UD e Drejtoreshes per Buxhet dhe Financa, e cila fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoje dhe e sqaroi kerkese per bartjen e te hyrave vetanake nga viti 2025 ne vitin 2026 para anetarve te Kuvendit.

z.Jetmir Tofaj, përshëndetje per te gjithë, ne kete pike e kemi diskutuar edhe ne mbledhjen e KPF_se dhe aty na eshte komtuar nga zyrtari i larte per buxhet z.Arten Hamza, se shuma prej 23000 € do te shkojnë pagese per borgje te rrymës, ka pasur kercnime nga KESCO per shkyqje, dhe nëse nisemi prek asaje se kryetari komunës eshte nje maxhister i ekonomisë dhe mikro menaxhim nuk do ta kishte problem fare, sepse komuna e Junikut eshte nje komune e vogël me staf te vogël dhe rrjedhimishte e konsideroj menaxhim te dobët dhe jo efikase qe te kemi nje shume prej 23000€ borgje dhe te marim kercnim nga ana e KESCOS per shkyqje, per kundër kesaje LVV eshte kostruktive dhe nuk dëshirojmë te bllokojmë buxhetin qe eshte per te mirën e qytetarve te Komunes se Junikut ne do e mbështesim bartjen e këtyre mjeteve me vote per.

z.Ruzhdi Shehu, përshëndetje per te gjithë, qeshtja e rrymës, nuk ka te beje me menaxhimin por kosoja eshte rritur, kete problem e kane edhe komunat tjera, por ne si komune kemi nje buxhet te vogël dhe duhet me tentuar qe ti ulim shpenzimet ne nje gjendej kur kemi krize energjetike ne nivel te vendit por edhe nivel global, dhe ne si komune do te shiqojme qe këto shpenzime ti ulim aq sa parshihen me standatet.

z.Leonard Llolluni, kerkese tjetër nuk ka e qes ne votim kërkesën per bartjen e te hyrave vetanake nga viti 2025 ne vitin 2026, kush eshte per, per 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kërkesa per bartjen e te hyrave vetanake u miratua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i plotësim ndryshimeve në rregulloren Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave,

Sqarimin dhe arsyetimin e plotësim ndryshimit te rregullores komunale per menaxhimin e mbeturinave e beri z.Demokrat Ganijaj, UD i drejtorit per shërbime publike i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi plotësim ndryshimin e rregullores komnale per menaxhimin e mbeturinave para anetarve te kuvendit.

z.Lulzim Gacaferi, përshëndetje per te gjithë, çmimni qe keni vendosur ne tabele a eshte çmim i vendosur nga ju apo nga operatori? Nuk eshte ne detaj i specifikuar se nga ka ardhur ky çmim.

z.Demokrat Ganijaj, me dt:02.12.2022 ministrja znj,Artane Rizvanoli ka mare vendim per rritjen e çmimit per deponi te mbeturinave , kjo rritje vlene deri ne vitin 2027, ku prej viti pasues 2022 per çdo vite te rritet çmimi per 1 euro ne deponi, dhe vendimi ka hyre ne fuqi nga 01.01.2023, andaj çmimin nuk e ka përcaktuar operatori sepse ligji ja japë kompetencat komunës, ne nga kuvendi komunal kemi mare nje te drejte per themelimin e komisionit punues, nga ky komision kemi ardhur ne përfundim qe eshte e nevojshme nje ngritje e çmimit prej 15% per secilën kategori.

z.Lulzim Gacaferi, ky grupi punues a ka parapare qe familjet me asistence sociale te lirohen nga kjo pagese.

z.Demokrat Ganijaj, 99% e familjeve te komunës se Junikut janë te kyqura ne kete ne kete shërbim dhe nga operatori ekonomik kemi hasur ne mirëkuptim qe familjet me asistence sociale te lirohen nga pagesa .

z.Burim Kuçi, përshëndetje per te gjithë, sa keni informacion se eshte rritja ne total, 1€ eshte rritja, po mua po me intereson ne total.

z.Demokrat Ganijaj, nuk llogaritet ne total por llogaritet ne përqindje per secilën kategori.

z.Burim Kuçi, e bëra kete pytje sepse ne te ky operatori kemi dy puntore qe punojnë dhe duke e mare parasyshe punën qe e bëjnë dhe puna qe eshte e rende e shohë te arsyshme qe ju si grupe punues por edhe operatori ta merni ne konsiderate edhe rritjen e pagës per këta dy puntor, kjo eshte kërkesa e pare ndërsa kërkesa e dyte eshte qe inkasanti te kete nje zyre ktu ne Juni, kjo do

te ishte e mire per te gjithë qytetare e komunës qe perposa pagese qe te bëjnë ne ate zyre, te kenë mundësin edhe te parashtroin ndonjë kerkese apo ankese, këto janë dy kërkesa te grupit te AAK_se, ne sot e përkrahim ne leximin e pare kete plotësim ndryshim te rregullores per mbeturina por ne qofse këto dy kërkesa nuk meren parasyshe ne nuk do ta përkrahim ne lexim te dyte.

z.Demokrate Ganijaj, sa i perkete pagës per dy puntoret eshte qeshtje e mbrendshme e operatorit dhe me aq sa kame informata pagat ju kane rritur konform ligjit, edhe per page por edhe per zyre une mundem me angazhuar nje takim me operatorin juve si shef i grupit te AAK-se por edhe grupeve tjera dhe me i diskutuar këto tema.

znj.Litafete Isufaj, përshëndetje per te gjithë, vetëm deshta te sqaroje qeshjne lidhur me pagesat per mbeturinat te inkasanti, une dua te ju informaoje se operatori ekonomik ne fjale ka marrveshje me posten e Kosoves qe këto pagesa te kryhen edhe ne Poste, andaj qytetaret nuk kan nevoje te bëjnë pagesa ne rruge por munden me be ne zyrën e Postes, andaj pe sho te pa nevojshëm qe inkasanti te kete ne zyre.

z.Burim Kuçi, po meqë po kërkohet nje rritje e tille pse mos te kete edhe inkasanti ne zyre dhe ne si qytetare do e kishim me te letë se ku te drejtohemi si per pagesa por edhe per qeshtje tjera siq e kane edhe operatoret tjer ekonomik si Hidrodrini.

z.Jetmir Tofaj, ne kete plotësim ndryshim te rregullores e kemi diskutuar edhe ne mbledhjne e KPF_se dhe aty e kam ngrite qeshtjen qe ngritja e përshkallëzuar e çmimit te behet 50cent nje vite dhe 50cent ne vitin tjetër, por kjo me siguri shkakton nje mori procedura tjera, qe me u miratua ne dy lexime, dhe ne pajtohem me kerkesn e z.Burim Kuçi qe operatori te kete nje zyre, ku përpos pagesave dhe marrjes se faturave qytetaret mun di shprehin kërkesat , shqetësimet e tyre, ne mandati e kaluar keni filluar te ndërtoni nje kompani publike, ndoshta ne kete mandat e pakta do ishte nje zyre.

z.Ruzhdi Shehu, qeshtja e ngritjes se çmimit eshte qeshtje e nivelit qendrore, per zyre pajtona qe edhe ky operator ekonomik te kete zyer, une do te bisedoje me operatorin per kete qeshtje, ndërsa sa i perkete pagës, kete qeshtje e rregullon ligji i pagave.

z.Jetmir Tofaj, pse po thuni se ngritja e çmimin eshte qeshtje e nivleit qendror, ku ne sot e kemi si pike.

z.Ruzhdi Shehu,niveli qendror ka përcaktuar qe te kete rritje te çmimit ne deponi, andaj kjo po e përcakton eshë rritjen e çmimit per grumbullim te mbeturinave.

z.Leonard Llolluni, kerkese tjetër nuk ka e qes ne votim kerkese per plotësim ndryshim te rregullores komunale per mbeturina, kush eshte per, per 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se kërkesa per plotësim ndryshim te rregullores komunale per menaxhimin e mbeturinave u miratua.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Kuvendit të Junikut për vitin 2025,

Arsyetimin dhe sqarimin e beri Kryesuesi i kuvendit z.Leonard Llolluni.

z.Shpejtim Gacaferi, përshëndetje per te gjithë, e potencuar se ky raport i Kuvendit i nevoitet ekzekutivit per perfomance, po ashtu ky raport mbetet ne arkiven e komunës, dhe per deri sa nevoitet per perfomance dhe mbetet ne arkive une do i përmendi disa gabime, me shume te natyrës teknike, me qellim qe raporti te permisohet une do ti përmendi këto gabime, faqe 2, ne raport thuhet se kjo eshte legjistratura e gjashtë (6), duhet te jete legjistratura e pestë (5), pastaj te perfaqsimin i gjenisë thuhet ne raport se kuvendi komunal ka qene i përfaqësuar nga tetë (8) meshkuj dhe shtatë (7) femra, duhet te jete nentë (9) meshkuj dhe gjashtë (6) femra, ne te njëjtën faqe, përcaktimi i panelit prej tre (3) personave per përzgjedhjen e anetarve te komiteti per persona me aftësi te kufizuara, ky komitet nuk eshte themeluar ne vitin 2025 por me herer, pastaj themelimi i komisioni per vlersimin e situatës se deponis se mbeturinave inerte edhe kjo nuk eshte themeluar ne vitin 2025 por me herët, faqe tre (3), ne raport thuhet se janë mbajtur tri (3) seanca te jashtëzakonshme, duhet te jete janë thirrur tri (3) senaca te jashtëzakonshme por vetëm nje (1) eshte mbajtur, dy (2) te tjera kane dështuar ne munges te korumit, ne te njeten faqe, ne raport thuhet , rregulloret e miratuar nga ana e kuvendit te komunës gjate viti 2022, te permisohet viti te behet 2025, faqe shtatë (7), po filloj na gjysma e faqes, ne rapoer thuhet, ne mbajtjen e kuvendit te komunës statusin e kuvendit te Junikut dhe rregulloren e punës se kuvendit,duke u ballafaquar (nisem nga gjysma e faqes) me probleme si te natyrës teknike, logjistike, ashtu edhe te natyrës ligjore dhe bashkëpunimit me ekzekutivin sa u perkete sa u perkete rrespektimi te proceduarve ligjore lidhur me shqyrtimin dhe iratimin e dokumentev strategjike komunale, une ne cilsine e kryesuesi as njeh ete nuke e kam then por as ju si anetare te kuvendit nuk e keni thene qe kemi patur probleme te natyre teknike apo logjistike, as nje here nuk e kemi thene se mungon bashkëpunimi me ekzekutivin, bilem kam thene se kryetari i komunës mer pjese me se shumti ne mbledhjet e kuvendit po ashtu edhe drejtoret per pos z.Demokrat Ganijaj, jo qe ai nuk ka dashtur por ka qene kerkese e anetarve te opozitës qe ai te mos jete prezent ne mbledhje, edhe kjo kisha dashtur te permisohet, dhe fjalia e fundit, ku thuhet falemenderimi per legjistraturen e gjashte (6), duhet te jete falemenderimi per legjistarturen e pestë (5) 2021-2025, kto janë vrejtjet e mija.

z.Leonard Llolluni, kerkese tjetër nuk ka e qes ne votim raportin e punës se kuvendit per vitin 2025 me këto ndryshime te paraqitra na z.Shpejtim Gacafer, kush eshte per, per 13 vota, kundër 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se raporti i punës se kuvendit per vitin 2025 u miratua me ndryshime.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e planit tre (3) vjeçar për strehim social,

Sqarimin dhe arsyetimin e beri z.Fatos Shala, UD i drejtoris per Shendesi, i cili fillimisht i përshëndeti te gjithë me pas e sqaroi dhe e arsyetoi inicimin e proceduarve per hartimin e planit tre (3) vjeçar per strehim social para anetarve te kuvendit.

z.Jetmir Tofaj, ne po dimë se eshte vetëm inicim, por drejtor a mundesh me na shtjelluar se çka përmban ky plan, ne pika te shkurta.

z.Fatos Shala, vete emërtimi strehime social po nënkupton se për çka behet fjale, por fillimisht do te themelohet grupi punues dhe do te hartohet ne perpushmeri me nivelin qendror dhe te harmonizohet me komuna tjera, specifika e komunës tone, vetëm kjo ndryshon.

z.Jetmir Tofaj, po a do te kete banim social, per kete ka bere thirrje qeveria qendrore, dhe a ka përfituar komuna jone prej kësaj thirrje.

z.Fatos Shala, do te shofim, ne kemi qen ne nje takim me nivelin qendrore, qe te aplikojm ne kete thirrje te qeverise, por problemi i komues tone eshte se nuk kemi hapsira publike te mjaftushme, dhe tani e tutje do te shohi qe te sigurojmë eshë hapsir publike te mjaftushme.

z.Lulzim Gacaferi, a ka komuna jone projekt per kete qeshtje, meqë ministria perkatse ju ka ftuar ne takim, a ka komuna projekt konkret.

z.Fatos Shala, ne tani jemi ka iniciojmë proceduar per te hartuar kete plan.

z.Ruzhdi Shehu, qeshtja e udhëzuesit te hartimit te planit per banim social eshte qeshtje e politikes qendrore dhe te gjitha komunat ju kan bashkangjitur me ato kapacitete qe kane, qe edhe ne te përfitojmë nga ky plani duhet te formojmë nje grupe punues qe te hartoj plani mbi banimin social, ndërsa neve si komune na mbetet si mundsi e gjetjes se hapsirave per ndërtimin e tyre.

z.Jetmir Tofaj, projekt ligji qe eshte miratuar nga qeveria parashe krijimin e programeve te banimit përmes përcaktimit te rregullave, procedurave te zbatimit te shpërndarjes se banesave, besoje se edhe ky plane do te permbaje te njëjtën, kriteret, proceduart per shpërndarjen e banesave, por ne si komune jemi te pika e pare, nuk i kemi banesat akoma, e para kesa edhe lokacioni, para kësaj mbledhje ne kemi pasur nje vendim per pronat qe ipen ne shfrytëzim nga drejtori i urbanizmit dhe kadastër, a qaq e pa mundur eshte me gjetur nje lokacion, sepse ne ate liste duhet te kete nje lokacion, ne menyre qe ne këtu mos ta miratojmë nje plan, te miratojmë ne plane vetëm qe te perputhet me nivelin qendror, e te mos na nevoitet asgjë, une mendoj se komuna mund te perfitoje nga ky projekt nëse ecim me hapa me te shpejte ne kete aspekt.

z.Fatos Shala, kete plane e kane hatuar vetëm katër (4) komuna, eshte Gjakova, Drenasi, Podujeva dhe (nuk dëgjohet qarte nga cingrrima e telefonit), komunat tjera te gjitha janë ne proces te njejte si ne.

z.Ruzhdi Shehu, ne kemi te bejem me nje nisme ligjore qe dueht te meret ne Kuvend, pastaj per çdo ecuri tutje do te jete i njoftuar edhe kuvendi, tani eshte nisma per krijimin e nje grupi punues i cili do te meret me këto politika, asgjë tjetër, dhe ne kemi shprehur gadeshmeri qe kete qeshtje ta shtyem përpara.

z.Leonard Llolluni, meqë jemi te kjo pike, qe eshte mjaft e ndishme, dhe po ashtu e di se sa e veshtire eshte edhe mirëmbajtja e komunës këto qendra sociale sepse kan nje kosto te larte dhe ne si komune me bushet te voges eshte e pa mundur ti mirëmbajmë pa ndimen e qeveris qendrore, por përkundër kësaj ne duhet ti kemi këto sepse kemi njerze qe kane nevoje per këto banesa sociale siq e kemi rastin tani te z.Avni Gjocaj i cili per momentin nu ka shtëpi apo vend

ku te banoj, andaj kisha kërkuar qe komuna te shiqoje mundësin qe ti gjeje nje vend per te banuar keti qytetar.

z.Ruzhdi Shehu, pikerisht ky plan i aderson keto shqetsime qe u permenden ktu per keta persona siq eshte z.Avni Gjocaj, prandaj po e hartojme nje politik e cila duhet te na shtyje ne si qeverisje lokale te gjejme hapsira dhe mundesi qe ky objekt te ndertohet.

z.Jetmir Tofaj, une prap po them se nuk mjafton vetem plani, duhet perfitimi i thirrjeve te ndryshme nga niveli qendrore, siq eshte rasti per komunen e Shtimes, nje komune relativishte e vogel e cila ka nenshkruar memorandum bashkepunimi ne dhjetore te viti 2024 me ministrin e mjedisit, planifikimit hapsinore, per projektin renovim rindertim te shtepive private per familjet dhe individet e cenushme ne kuader te banimit social adekuat, kjo eshte nje thirrje qe do te kishte perfituar edhe komuna e Junikut per kete familje te cenushme me nje kosto te vogel.

z.Ruzhdi Shehu, sa per informacion ne si komune kemi nenshkruar memorandum bashkepunimi me ministrin e linjes dhe ne kete derjtim eshte ne proces e siper.

z.Zenun Shala, pershendetje per te gjithe, per me e vertetuar ate qe e tha kryetari i komunes, ne ju kemi pergjigjur thirrjes se ministris se linjes, ate thirrje e kemi publikuar ne web-faqe te komunes, dhe kemi familje qe kane aplikuar per rindertim dhe riparim te shtepive, dhe tash jemi ne fazen perfundimtare per ata qe kane aplikuar, dhe ministria na i ka pranuar te gjitha ato aplikime.

z.Leonard Lolluni, kerkese tjeter nuk ka une e qes ne votim inicimin e procedurave per hartimin e planit tre (3) vjeçare per strehim social, kush eshte per, per 3 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 0 vota, konstatoi se inicimi i procedurave per hartimin e planit tre (3) vjeçare per strehim social u miratua.

6. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),

Sqarimin dhe arsyetimin e themelimit te keshillit komuna per siguri ne bashkesi, e beri Kryetari i Komunes z.Ruzhdi Shehu.

z.Leonard Llolluni, kerkese nuk ka, e qese ne votim themelimin e KKSB_se, kush eshte per, per 12 vota, kunder 0 vota dhe abstenim 1votë, konstatoi se temelimi i KKSB_se u miratua.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i inicimit të procedurave për hartimin e “Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale” 2026-2030,

Sqarimin dhe arsyetimin e beri z.Tafë Tofaj- UD i drejtorit per Ekonomi dhe Zhvillim, i cili fillimisht i pershendeti te gjithe me pas e saqroi dhe e arsyetoi inicimin e proceduarve per hartimin e “Planit per Menaxhimin e Tokave Rurale” 2026-2030 para anetarve te kuvendit.

z.Leonard Llolluni, kerekes nuk ka, e qes ne votim, inicimit të procedurave për hartimin e “Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale” 2026-2030, kush eshte per, per 13 vota, kunder 0 vota dhe

abstenim 0 vota, konstatoi se inicimit të procedurave për hartimin e “Planit për Menaxhimin e Tokave Rurale” 2026-2030, u miratua.

8. Pyetje nga anetaret e kuvendit,

z.Jetmir Tofaj, po e rikethej edhe nje here perpjeken e rrymes ne lokaciona aruah, ku ne mbledhjen e KPF_se kryetar i Komunes na tha se duhet te mbledhen nenshkrimet e qytetarve te ati lokacioni, une ju njoftoje se qytetaret e kan bere mbledhjen e nenshkrimeve, dhe ju inkuaroje se ne tamikme me KESCO ta ngrisni kete qeshtje. Po ashtu kam patur nje ftese per takim nga Teqja e Junikut, edhe ata i kane disa kerkesa qe ende nuk jane permbushur siq eshte problemi me ujra te zeza qe nuk eshte problem vetem i teqes por edhe i banorve per rrethe si dhe i pengesave te shpejtesie se automjeteve ne rruge une kto kerkesa po i kumtoje sepse jue eshte premtuar nga ana e juaj (kryetarit) qe do te zgjedhen sa me shpejte, dhe une po shpresoje se kjo do te ndodhe.

z.Ruzhdi Shehu, qeshtja e ujrave te zeza ka qene edhe me heret, dhe ne jemi mare me kete qeshtje por kemi hasur ne problem te qeshtjes pronsore, por shpresoj se do ta zgjedhim kete qeshtje me komunikim te mbredshme, ndersa qeshtja e pengesave te shpejtesin se automjeteve do te shiqojme mundesi te behet ne menyren stadarte sepse ne disa lokaciona jane bere te teperta, por me rishqimin e buxheti do te shiqojme mundesit qe edhe ne ate ojese te kene keto pengesa, por edhe kanalizim per ujra te zeza.

z.Burim Kuçi, une kame dy pyetje per kryetarin, kryetar siq e dine ministrja znj.Pacolli ka mare vendit qe te ndalen te gjitha punet ne bshjekete , a eshte cekur edhe per bjeshtekt e Junikut, nese po a ka mare komuna ndonje vendim nga ministria?

z.Ruzhdi Shehu, jo vendim nuk kemi mare nga ministria, por kemi kekruat takim me ministrin gjegjse qe ti shiqojme mundesit e planeve te hollsishme.

z.Burim Kuçi, pyetaj e dyte ka te beje me ndreqimin publik ku ne disa lagje ka filluar te bjer tersishte, a keni ne plane te ndermerni masa , pasi qe keni premtuar drite, e me ju ba terr.

z.Ruzhdi Shehu, e kemi parasyshe kete gjendje dhe do te ndermarim masa qe te permesohen.

znj.Litafete Isufaj, une kam nje kerkese per drejtorin z.Demokrat Ganijaj per qeshtjen e kamerave te sigurise si jane mundesit qe ti vendosni disa kamera te siguris edhe ne lagjen Goçaj dhe Moronica.

z.Demokrat Ganijaj, ne e kemi patur nje projekt ne vitet e kaluara, ne shume prej 50000€, ku kemi beren ndertimin e rrjetit te kamerave te sigurise, ku nga ky projekt eshte mbuluar rrethe 70% e teritorit te komunes, ndersa tash kemi pranuar nje donacion nga KFOR Italian ne vlere prej 20000€, ku me pergjesi te plot e them se do ta mbulojme edhe ate 30% te teritorit te mbetur.

z.Lulzim Gacaferi, ne e dime se me ndertimin e rruges per bjeshken e Junikut eshte bere nje pune kolesiale nga qeveria e Albin Kurti, ku Komunes se Junikut do te ja mundsoje zhvillimin e turizmit ne ate pjese, dhe mua po me intereson ajo se a ka bere komuna ndonje plan qe ne zonen e trete te leshoje prona per palet e interesuar te investojne ne ate pjese pasi qe ligji e mundson te

kete  ndertime ne zonen e trete. Dhe a keni ne plan qe ne te ardhmen ne bashkpunim me KESCO te shtrin rrjetin elektrik edhe ne keto zona, e cila do te mundsonte edhe me shume zhvillimin e turizmit.

z.Ruzhdi Shehu, jemi ne pritje te bashkpunimit me KESCO sa i perkete shtrirjes se rrjetit elektrin ne ate pjese, ndersa sa i perkete zones se trete ajo eshte kopetenc e Parkut Nacional, dhe mbikeqyret nga niveli qendror nuk ka mbikqyrje te nivelit lokal, ne zonen e trete lijodhet zhvillimi por paraprakisht mbikqyret nga Parku Nacional.

z.Jetmir Tofaj, ne mbledhjen e fundit kam bere pyetje lidhur me uzupimet dhe me eshte thene se ne kete mbledhje do ta kem pergjigjen, por ne te njeten kohe e kemi ligjin qe e trajton ndertimet pa leje qe mundeson legazlizimin e objekteve derin ne vitin 2026 nese nuk gabohem, dhe keto jane procese qe bejne qytezen me qene me  urbane, rregullimi edhe i uzupimeve, trajtimi i ndertimeve pa leje si dhe rregullimi i varrezave, ne jemi prezent ketu dhe qytetaret ende nuk i varrosin ne varrezat e qytetit, ne komuna tjera kjo qeshtje eshte e rregulluar dhe nuk guxojne ti vorrosin diku tjeter perpos ne varrezat e qytetit,ndersa ne komunen tone jo, une mendoj se duhet te ndermerni masa per kete qeshtje.

z.Ruzhdi Shehu, sa i perkete uzupimeve, lendet jane ne organet e drejtesis dhe jane duke u shqyrtua, ndersa sa i perkete varrezave, ka nje rregullore te menaxhimit te varrezave dhe shume shpejt do te trejtohet.

9. Te ndryshme.

z.Leonard Llolluni, para se te dalim te kjo pike, ne mbledhjne e kaluar e keni mare ftesen per trajnimin e anetareve te rei te kuvendit dhe ju njoftoje edhe nje here se trajnimi i pare eshte me dt;02.04.2026 ne Peje, dhe kush ka mundesi te shkoje materialin ja kam dergualr ne mbledhjen e fundit, dhe si pike tjeter eshte me rendesi qe secili na ju te shkoni te zyrtari i IT z.Rrustem Pepshi te fotografohi pasi qe po kerkohet per publikim ne web-faqen e komunes.

z.Lulzim Gacaferi, qeshtja ka te beje asfaltimi i rruges ne lagjen Gacafer, me aq sa ndegjova nga raporti qe beri drejtoresha per buxhet dhe finaca, tha se ka perfunduar faza e pare e afaltimit keshtu mu duk se degjova pasi qe nuk u degjojke mire, mua po me intereson kur kryhen fazat dy dhe tre, une e di se komuna ka buxhet te limituar por fartmesisht e kemi qeverin qendrore dhe qeveria eshte e fuqishme dhe ata munden te na sjellin mjete finaciara ashtu siqe kane sjelluar gjithemon.

z.Ruzhdi Shehu, faza e pare eshte kryer por qeshtja eshte te buxheti por me duhet te shkoje nja dy dite ne Prishtin per kete qeshtje dhe kjo do te kryhet.

z.Leonard Llolluni, e shpalli te mbyllur mbledhjen e Marsit 2026

| | |
|---|---|
| Procesmbajtësi: | Kryesuesi i Kuvendit |
| z. Esat Hoxha | z. Leonard Llolluni |
| ________________ | ___________________ |

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E JUNIKUT
OPSTINA JUNIK/ MUNICIPALITY OF JUNIK

# KOMUNA E JUNIKUT

# RAPORTI I BUXHETIT KOMUNAL PËR PERIUDHËN JANAR - MARS/ 2026

**Junik, Prill -2026**

# Informata -I- Financiare Periodike 2026

## Kërkesat për raportim

Informata Financiare Komunale për periudhën Janar – Mars 2026, bëhet në bazë të kërkesave për raportim të përkohshëm dhe vjetor bazuar në dispozitat e neneve 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 "Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë" dhe statutit Komunal.

Informata Financiare Komunale Periodike ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe me treguesit relevant rreth përmbushjes së planit të grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas plan programeve, dinamikën e mjeteve të shpenzuara dhe atë sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë ndikuar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë.
Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesve do të prezantohet për 15 programet buxhetore :

1. Zyra e Kryetarit
2. Kuvendi Komunal
3. Administrata e Përgjithshme
4. Buxhet dhe Financa
5. Zhvillim Ekonomik
6. Shërbimet publike dhe Inspeksion
7. Urbanizëm, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedis
8. ZKK ( Zyra Komunale për Komunitete)
9. Shëndetësi
10. Mirëqenie Sociale
11. Shërbimet e kujdesit primar
12. Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
13. Arsimi parashkollor
14. Arsimi fillor
15. Arsimi i mesëm

## TË HYRAT DHE SHPENZIMET BUXHETORE PERIODIKE

Ky raport financiar është përgatitur në përputhje me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare te Kontabilitetit ne Sektorin Publik) të bazuar në para të gatshme "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme". Shënimet në pasqyrat financiare paraqesin pjesë integrale për ta kuptuar pasqyrën, andaj duhet të lexohen së bashku me pasqyrat.

Pasqyrat financiare janë për Komunën e Junikut. Komuna e Junikut kontrollohet nga Qeveria e Kosovës dhe të gjitha aktivitetet e saja financohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Komuna e Junikut nuk operon me llogarinë e vet bankare. Qeveria operon me funksion të centralizuar të Thesarit i cili e administron pranimin e parave të gatshme të mbledhura nga të gjitha entitetet buxhetore gjatë vitit financiar. Pagesat e bëra në këtë llogari sa i përket Komunës së Junikut janë të paraqitura në kolonën e llogarisë së vetme të Thesarit në Pasqyrën e Pranimeve dhe pagesave të Parave të Gatshme.

Buxheti i aprovuar në Asamblenë Komunale për vitin 2026 është në vlerë **2,538,612.00€** i cili ka pësuar ndryshime gjatë periudhës Janar – Mars 2026 për të hyrat nga donacionet dhe donacionet e bartura nga viti 2025 në vlerë **373,113.65€.** Buxheti përfundimtar i përgjithshëm duke përfshirë edhe donacionet është në vlerë **2,911,725.65€.**

## Raport i ekzekutimit të Buxhetit

| | | Buxheti fillestar | Buxheti Aktual | Pranimet - Alokimet | Pagesat (Shpenzimi) | Progresi me plan | % me alokim |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përshkrimi | | Ligji Nr. 10/L-001 | SIMFK | SIMFK | | në, % | në, % |
| a | | b | c | d | e | f=e/c | g e/d |
| **Gjithsej Pagesat** | | 1+2+3+4+5 | 1+2+3+4+5 | 1+2+3+4 | 1+2+3+4+5 | | |
| **Totali** | | **2,538,612.00** | **2,911,725.65** | **1,403,992.18** | **666,172.47** | 22.88% | 47.45% |
| Paga dhe Meditje | | **1,898,712.00** | **1,898,712.00** | **575,539.20** | **575,539.20** | 30.31% | 100.00% |
| Mallrat dhe Shërbimet | | **313,500.00** | **313,517.50** | **309,196.50** | **59,756.62** | 19.06% | 19.33% |
| Shpenzimet Komunale | | **54,900.00** | **54,900.00** | **54,900.00** | **21,468.25** | 39.10% | 39.10% |
| Subvencione dhe Transferet | | **70,000.00** | **70,000.00** | **35,000.00** | **-** | 0.00% | 0.00% |
| Investimet Kapitale | | **201,500.00** | **574,596.15** | **429,356.48** | **9,408.40** | 1.64% | 2.19% |
| **Granti i Përgjithshëm** | 1 | **2,343,311.00** | **2,343,311.00** | **1,020,138.20** | **660,508.42** | 28.19% | 64.75% |
| Paga dhe Meditje | | 1,898,712.00 | 1,898,712.00 | 575,539.20 | 575,539.20 | 30.31% | 100.00% |
